

There are no translations available.

Nga data 26-27 nëntor 2012, Presidenti i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, z. Gëzim Kalaja mori pjesë në Forumin e 4-të të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Zagreb. Nga folës të vendeve të ndryshme u ngulmua kryesisht në këto probleme:

1. Si të përmirësojmë lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave?
2. Si të përfshijmë organizatat e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE?
3. Zhvillimi rural dhe punësimi në Ballkanin Perëndimor
4. Mundësitë për bashkëpunim në të ardhmen

Presidenti i BSPSH-së, zoti Gëzim Kalaja i drejtoi Z. Štefan Füle dhe Eduard Kukan, të pranishëm në këtë takim, këto pyetje:

1. Në raportet e Bashkimit Europian për Shqipërinë gjithmonë ndeshemi me termin shoqëri civile dhe rolin e saj dhe, nuk përmenden fare sindikatat ose shumë pak. Kur duhet kuptuar se midis sindikatave dhe shoqërisë civile ka një ndryshim të madh në strategjitë dhe veprimtarinë e tyre. Sindikata ka anëtarësi në shkallë kombëtare dhe përfaqëson botën e punës e të pensionit, ndërsa shoqëria civile ka vetëm një forum drejtues. Sindikata është faktor në jetën social-ekonomike të vendit, sepse përfaqëson shtresën që prodhon, si dhe jep kontribut në legjislacionin e punës. Nuk i kemi të qarta arsyet e një mosvëmendjeje të tillë? Mendoj se Komisioni Evropian, gjithashtu edhe BE duhet ta kenë parasysh këtë vërejtje dhe të jenë të vëmendshme për rolin e madh të sindikatave, duke i lënë atyre vendin që i takon në raportet e paraqitura për Shqipërinë.

2. Në vendin tim populli kërkon futjen e Shqipërisë në BE dhe merr mbi vete të pranojë të gjitha kushtet e vëna nga Komisioni dhe BE, pavarësisht kostos sociale. Shkaktare dhe pengesë tek ne për anëtarësimin tonë në BE është politika me konfliktualitetin e saj, ashtu sikundër edhe ju e dini. A mendoni se politika shqiptare do ta kapërcejë këtë pengesë, sikurse e kërkon populli shqiptar?

Staffan Nilsson, president i EESC, që uroi edhe mirëseardhjen, paraqiti një një periudhë të turbullt krize që po kalon BE por, që do të kalohet. Dua që ta shikoni gotën gjysmë plotë dhe jo gjysmë bosh. Pjesëmarrja e z. Füle është një shenjë e mirë për të gjithë shoqërinë civile. Duhet të kemi organizata të forta dhe të loboni me qeveritë tuaja, theksoi ai. Duhet të ketë sindikata të forta që të kritikojnë me zë të lartë politikat e gabuara të qeverisë. Liria e shprehjes dhe liria e medias, si dhe punësimi rural është shumë i rëndësishëm për BE.

Ministrja e jashtme e Kroacisë theksoi vlerësimin që vendi i saj i bënte sindikatave: Në komisionin e Kroacisë për futjen në BE, përveç përfaqësuesve të qeverisë, kemi patur përfaqësues nga sindikatat, shoqëria civile dhe akademikë, sepse të gjithë duhet të përfshihen.

Më pas Štefan Füle në fjalën e tij iu përgjigj edhe Presidentit të BSPSH-së z.Kalaja: Unë e marr shumë seriozisht vërejtjen tuaj që sindikatat të kenë vendin e tyre në raportet tona dhe ne, këtë do ta bëjmë duke i dhënë vendin e tyre, si sindikatave dhe shoqërisë civile. Për Shqipërinë qeveria duhet të bëjë përpjekjet e saj që opozita të mos lejohet të bëjë kërkesa artificiale dhe këtë qeveria duhet ta ketë gjithnjë parasysh. Qeveria dhe opozita duhet të kontribuojnë bashkërisht, ky është rekomandimi i BE-së. Unë ju bëj me dije se të gjitha problemet që u diskutuan do t'i bëhen prezente qeverive dhe mediave në vendet tuaja.

Jam i kënaqur që kontribuoj për vendet e Ballkanit Perëndimor. Të vihet sundimi i ligjit nga ato vende që duhet të bëhen anëtare të BE. Drejtësia në gjyqësor, krimi i organizuar , korrupsioni dhe lufta kundër tij, zbatimi i ligjit, vendosja e rendit dhe mbyllja e konflikteve ballkanike duhet të jenë prioritete. Lista e çështjeve për t'u anëtarësuar është shumë më e gjerë. Ne duhet të stabilizojmë proceset ekonomike, zgjerimi është i rëndësishëm për reformat ekonomike. Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme sidomos në marrëveshjet ndërpartiake. Ne nuk do të hapim bisedimet por statusi duhet të jepet. Shqipëria duhet të vazhdojë reformat dhe kushtet e vëna nga BE. Roli kyç i shoqërisë civile dhe sidomos i sindikatave, është krijimi i një ure mes qeverisë dhe komunitetit.

Duke iu përgjigjur zotit Kalaja dhe duke pranuar shqetësimin e tij, ai vazhdoi: Dialogu aktiv midis sindikatave dhe qeverisë sjell zgjidhje të problemeve. Qeveritë duhet të krijojnë një mjedis të kënaqshëm. Qeveritë dhe sindikatat duhet të marrin përgjegjësitë. Qeveritë e vendeve që duan të hyjnë në BE duhet të punojnë bashkërisht me shoqërinë civile dhe sindikatat në përputhje me Nenin 49.Ne, në këto bisedime duhet të përfshijmë shoqërinë civile dhe sindikatat, sepse vetëm në këtë mënyrë do të ndërjegjësohet komuniteti i një vendi në lidhje me kushtet e BE. Shpresojmë që Shqipëria do të zgjidhë problemet e brëndshme. Ju, sindikatat i ndjeni shumë problemet e shkaktuara nga kriza dhe kjo duhet të zgjidhet nga elita politike dhe ju, si pjesë e shoqërisë civile. Që një reformë të ketë sukses duhet të mbështet nga opinion publik, gjithashtu dhe hyrja në BE.





